



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01- Nr - 464/01- 1844 dt. 19.01. 2021

Në vështrim të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 12-464/01-51562, i datës 26.11.2020, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për hartimin e Elaboratit Kadastral - Gjeodezik, sipas vendimit Nr. 12-464/01-51562, i datës 26.11.2020, për shhpronësimin e njësive të ndërtesave-banesave, në zonën kadastrale në Glllogoc

I. Anëtarët e komisionit për hartimin e Elaboratit Kadastral - Gjeodezik, sipas vendimit Nr.12-464/01-51562, i datës 26.11.2020 janë:

1. Safet Hoxha, gjeodet (kryetar),
2. Granit Hasanaj, jurist (anëtar),
3. Fadil Tahiri, gjeodet (anëtar).

Komisioni ka për detyrë të bëjë hartimin e Elaboratit Kadastral - Gjeodezik, sipas vendimit të Kuvendit të Komunës së Drenasit Nr. 12-464/01-51562, i datës 26.11.2020, për shhpronësimin e njësive të ndërtesave-banesave, të cilat ndodhen në parcelen 743/29 (ish parcela 743/1), në zonën kadastrale në Glllogoc

II. Ky komisioni, punën e tyre duhet ta kryejnë me profesionalizëm të lartë dhe përkushtim, si dhe në një afat të arsyeshëm të dorëzojë hartimin e Elaboratit.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Anëtarëve të Komisionit;
- DGJKP-së;
- Arkivit të Komunës së Drenasit.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci